



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 5313/1 Prot.

Lezhë, më 20. 05. 2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në datën 20.05.2025, në orën 11:00, në Bibliotekën “Gjergj Fishta” Lezhë, mbi dëgjuesën publike në lidhje me projekt vendimin “Për hapjen e rrugës publike në fshatin Ungrej, Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë” dhe me projekt vendimin “Për miratimin e hapjes së rrugës së varrezave të fshatit Rras, Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë, në fondin pyjor bashkiak”

Të pranishëm janë këshilltarët Erin Ndreca, Pjeter Noka, Alfons Trashaj, Pjeter Gjinkola.

Takimi u hap nga Kryetari i Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Ndue Luli, i cili shprehu vlerësimin e tij për këtë gjë, që u shërben banorëve të asaj zone, si dhe tha që prandaj bëhet kjo dëgjuesë, për të dëgjuar specialistët, për të dëgjuar banorët, në mënyrë që më pas të kalojnë në këshill për miratim.

Kryetari i dha fjalën Drejtorit të Urbanistikës z. Flamur Kuçi.

-Flamur Kuçi: Përshëndetje të gjithëve. Siç tha dhe kryetari, jemi në një konsultë publike. Drejtoria e Urbanistikës ka bërë relacionet përkatë nga ana teknike për rrugën në fshatin Ungrej dhe për rrugën e varrezave në fshatin Rras në fondin pyjor bashkiak.

Kryetari i dha fjalën përgjegjësit të Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve në Drejtorinë e Bujqësisë në bashki, z. Artan Palushi.

-Artan Palushi: Përshëndetje të gjithëve. Këtu bëhet fjalë që po ndodh një ndryshim në territor, duke u përmirësuar infrastruktura me rrugë që i shërbejnë komunitetit, për të aksesuar varrezat. Ne kemi bërë matjet në pyll dhe kemi nxjerrë gjatësitë që kjo rrugë prek në fondin pyjor. Aktet ligjore janë shumë të qarta. VKM nr. 888 për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimirt të territorit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimin në sipërfaqe dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimi i tyre. Tani kemi të bëjmë me një rrugë e cila ka një gjerësi 4 metra dhe kjo VKM që citova unë thotë që të gjitha veprat rrugore që nuk kalojnë gjerësinë 10 metra, përfshirë pankinat, nuk hiqen nga fondi pyjor, por bëhet mbajtja e të dhënave në regjistrin kadastral pyjor, që do të thotë që ndodh ndërtimi i rrugës dhe ne përditësojmë kadastrën tonë duke mbajtur shënim sa drurë priten, sa është volumi i tyre te kjo sipërfaqe që u kthye rrugë tashmë. Gjithashtu në kuaër të kësaj vepre që doo ndërtohet, parashikohet që ajo sipërfaqe që u dëmtua, t'i

kthehet prapë zonës aty. Ne kemi parashikuar që të pyllëzohen skarpatat e rrugës, duke kryer dy funksione, edhe kthimin e sipërfaqes pyjore në kuadër të rehabilitimit mjedisor por edhe sistemimin e skarpatave për të eliminuar problemet e rrëshqitjes në mënyrë që rruga të ketë qëndrueshmëri në afatgjatë.

Këto janë gjëra tenike që i parashikon ligji.

Jemi dakordësuar dy struktura brenda bashkisë që kjo punë të bëhet dhe të bëhet sa më mirë.

Faleminderit për vëmendjen.

-Ndue Luli: Kush e do fjalën për pyetje, diskutime?

-Frrok Preng Gjin Lleshi, banor: Jam i gëzuar që e ka marrë këtë iniciativë bashkia të shkojë ajo rrugë atje. Ua bëftë Zoti hallall.

-Ded Doda, Kryeplak: Kjo është problematikë prej vitesh, e njoh mirë atë zonë. Kam një falenderim të veçantë për këtë rrugë sepse ka qenë e pakonceptueshme të mos kishte rrugë varrezash. Bëj thirrje të mos ketë pengesa për çështje pronësie.

-Banor: Unë falenderoj këshillin e bashkisë që e ka marrë parasysh kërkesën tonë, si dhe për specialistët e bashkisë që e kanë përgatitur. Unë jam i bindur që nuk do ketë asnjë lloj pengese, por të bëhet sipas parametrave.

-Banor: Ju përgëzojmë. Është mirësi për gjithë banorët. Vetëm të jetë sipas parametrave.

-Agustin Zefi, administrator: Falenderoj bashkinë dhe banorët e dy fshatrave si dhe ju zoti kryetar i këshillit.

-Banor: Falenderoj Bashkinë e Lezhës për ndërtimin e kësaj rruge.

-Ndue Luli: Për çdo rast që ka të bëjë me pronat bëhet konsultim publik.

-Ndërhyri një banor duke theksuar nevojën për standarte.

-Flamur Kuçi, Dr. Urbanistikës: Thjesht sa për sqarim, për 33 rrugë që ka filluar ndërtimi i tyre, projektimi është bërë nga studio të specializuara.

-Ndue Luli: Ju falenderoj shumë për pjesëmarrjen.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
NDUE LULI

